

Ermira Jorgo

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SSH-32

J 76

**MENGJESET
E PARA
tregime**

85H-32
J 76

Redaktor
KUMITURI PËRSHËRË

Ermira
Jorgo

1208



Mëngjeset
e para
Tregime

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Y L B E R I

Treni nisej në orën pesë. Nata kishte një dritë të çuditshme. «Tani jam vetëm fare», mendova dhe më erdhi keq. Ecja nëpër mjegull si nën një kambanë qelqi opak. «Do të provojmë sa e fortë jam.» Nuk isha mësuar të largohesha për një kohë të gjatë nga shtëpia. Kur më doli emërimi për në qytetin E, u mërzita, sikur të më kishin bërë një padrejtësi. Po punën e emërimit s'e zija në gojë. E ndieja sedrën të lënduar, sepse babai nuk kishte ndërhyrë të më mbanin në Tiranë.

Do të doja të të kisha këtu, po mendoj se është më mirë të dalësh njëherë nga shtëpia. Duhet të shohësh njerëzit, tha ai duke u sjellë nëpër kuzhinë. Pulat rrinë në shtëpi, tha prapë, duke më parë vjedhur, dhe hyri në dhomën e tij, me librin nën sqetull dhe me pizhamatë të shkuara shtrembër.

Ngashërimi po më ngjitej në grykë. Ai kishte të drejtë, po nuk doja të më fliste ashtu.

«Unë do të pres të shtunën me gëzim dhe do të të kuptoj nga sytë si ke qenë.»

Nga shtëpia ika në mëngjes, pa bërë zhurmë. Tani e kuptoja pse s'i kisha zgjuar. Doja t'u vinte keq për mua. Kur mbërrita tek ura me gurë, u ktheva të shihja. Nëpër mjegull dallova një dritë të zbeh-të që duhej të ishte e dhomës së babait. Më kishte ndier dhe s'kishte folur.

U ngashëreva përsëri dhe vazhdova të ecja nën atë kabanën e mjegullt, me një dridhje të lehtë në gjunjë.

«Tani nuk është koha të qaj, — thashë, — më vonë.» E shihja si një punë që duhej bërë patjetër.

Po i afrohesha stacionit dhe fillova të dalloja njerëzit. «Secili ka kupolën e vet», thashë dhe nxitova të përzihesha me ta. Nga një rrugicë doli një grup djemsh. Duhej të ishin aksionistë. Njëri ecte përpara, me rrjetën hedhur në krah dhe një lloj shkopi në dorën e djathtë. Ishte trupvogël dhe dukej si fëmijë.

— Kujdes, çuna, një, dy tre:

*O moj Merushe,
moj topsheqere,
o ty të kemi,
moj, brigadiere...*

Të tjerët e pasuan. I vogli tundte shkopin me seriozitet, sikur drejtonte bándën e shtetit dhe përdridhte trupin si çupë. Kur u afruan te polici i

ATSH, pushuan dhe filluan të ecnin me hap rreshtor. Ata nga fundi mezi mbanin gazin, këndonin nën zë sikur t'u ishin zënë hundët.

— E çuna, nuk këndohet në këtë orë, — tha polici dhe i erdhi keq që ua preu këngën.

— Dakord, — tha i vogli dhe ngriti dorën. Kur u larguan pak, ai u kthye:

— Hajde, çuna, pjano, pjano, sondovoçe.

Në aksion u njohëm bashkë ne të dy...

Në stacion kishte dritë. Njerëzit nxirrnin avull nga goja. Shumica duhej të ishin punëtorë. Qeshnin e flitnin me zë të lartë.

«Nuk u vjen keq që kanë prishur gjumin. Janë mësuar.»

Hipa në vagonin e fundit dhe u ula pranë një plake.

— Mirëmëngjes!

— Mirëmëngjes, xhano, si u dive?

Drita e fortë që nga tavani përhapte nxehtësi. Në ndenjësën tjetër ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, me syzet në dorë dhe një libër të mbyllur përpara. Burri hapi librin, vuri syzet, lexoi nja dy minuta, pastaj e mbylli. Ndenji pak ashtu, duke parë mbi kokat tona, pastaj e hapi përsëri.

«Sikur merr yshqim» do të kishte thënë gjyshja ime. Vërtet kishte një mënyrë të çuditshme. Dukej sikur gëlltiste ato që lexonte.

Punëtorët e ndenjësës në të majtë se përse qeshnin me të madhe. Kishin secili nga një pako me bukën e mëngjesit të mbështjellë me gazetë.

Vërshëlëu lokomotiva duke çarë qetësinë e fushave që zbardhnin si argjend nga bryma. Kërcitën rrotat mbi shina. Sikur të kishin pritur vetëm këtë, njerëzit varën kokat dhe filluan të dremitin. Erdhi fatorinoja, me një nishan të zi në rrëzë të hundës.

— Biletat, ju lutem!

— Ngadalë, moj!

— Biletat, shok. Hajde, Xhato, biletën!

Kishin bërë shumë rrugë bashkë. Ajo i njihte punëtorët të gjithë.

Jashtë filloi të binte shi, një shi aq i imët, sa nuk linte gjurmë pothuaj as në ujë, po në lindje kishte shumë dritë. Kodrat, pemët, shtyllat, çdo gjë dukej në një plan, pa thellësi. Ende nuk kishin dritë. Retë e holla po merrnin formë. E gjitha kjo më dukej si një kuadër i vizatuar nga dora e një fëmije. «Ndoshta fëmijët janë më afër natyrës».

Plaka përballë filloi të hante. Shtroi një pecetë mbi tryezën pranë dritares dhe vuri mbi të bukën.

— Do hash pak? — tha.

— Jo, falemnderit, kam ngrënë.

— Mirë, xhano, si të duash.

Ishte e dobët, e veshur me një fustan atllasi dhe xhaketë të zezë. Hante nga pak, duke e shtypur bukën me gishta.

— Vete te djali, — tha, — e kam ushtar në Sazan.

Duhej të ishte nga Jugu.

— Këtë e kam të madhin. Kam edhe dy më të

vegjël. Mësojnë në shkollë. Po m'u dogj xhani për një çikë vajzë. Sa t'i martoj kam keq.

Plaka më pa sikur më donte nuse për djalin. Kur mbaroi, mblodhi buzët, i fshiu me dorë dhe shkundi thërrimet.

— Poqa një pulë t'ia shpie, po s'di a do t'i mbajë.

Ajo hoqi këpucët dhe mblodhi këmbët me çorape leshi nën vete.

«Një grusht plakë.»

Erdhi prapë faturinoja.

— Biletat, ju lutem. Uli këmbët, nëno, se është e ndaluar.

— Mirë, xhano, — tha plaka. Uli njërën këmbë, ndërsa tjetrën e mbajti nën vete.

Në telat e telefonit shndritnin pika uji. Bashkoheshin dy nga dy dhe shkëputeshin, të vogla, të tejdukshme, ngjyrë qielli.

«Gjërat marrin rëndësi kur bashkohen. Ja, si pikat e ujit.»

Hipi një kurbatkë me një fëmijë me monedhë në ballë. Trastën e mbante hedhur në shpinë si ushtar. U ul përballë meje dhe rregulloi frudat e fundit. Zbërtheu trikon, nxori gjirin e zeshkët dhe ia zuri gojën fëmijës, që nisi të thithte sikur do të mbytej. Nuk i vinte rëndë.

«Gjithë jetën ka ushqyer nëna fëmijën. Pse t'i vijë rëndë?»

— Më hëngri të gjallë, — tha kurbatka.

— E, moj dhe ti, — tha plaka, — të tërë kemi rritur fëmijë, — dhe pa nga unë sikur i kisha rritur fëmijët bashkë me të.

— Ku punon ti, shoqe? — e pyeti burri me librin e mbyllur.

— Ë? Ja, shes kanistra, — tha kurbatka.

— Pse s'punon si të gjithë? — Burri fliste duke i theksuar fjalët me lëvizje të tepruara të buzëve, sikur kishte të bënte me shurdhmemecë.

— Si të gjithë? Pse, s'janë punë kanistrat? Të të hedh një fall? — tha kurbatka dhe zbardhi dhembët sikur donte ta mernte me të mirë.

— Kush të lë ty të bësh punë private? — tha burri me libër i nxehur.

— Ato punë që thua ti, s'i di unë, more shok. Po më lër rehat tani! — Ajo filloi t'i binte fëmijës në faqe.

Burri nuk foli më.

Shiu kishte pushuar. Përreth çdo gjë dukej e larë.

Erdhi një ushtar dhe u ul pranë meje, vuri duart mbi gjunjë dhe ndenji me trupin drejt si nuse. Ushtari kishte zënë dy gisht vend dhe ruhej mës më prekte. Fëmija i kurbatkës kishte lëshuar gjirin dhe shqyente sytë. Plaka dremiste.

Ngá dritarja shihja qiellin të kaltër, të pafund, me një dritë të qartë, që e bënte të dukej si i thyeshiëm. Më dukej se e kisha brenda tërë atë dritë të kaltër dhe këtu fillova të ngatërroja masën. Pastaj e shihja të pasqyruar në ujërat e fushave dhe më dukej se treni ynë po shkonte nëpër qiell.

«Asgjë s'më pengon të shoh pa fund. E megjithatë nuk shoh dot qartë. Duhet t'i zbuloj shtresat një-rën pas tjetrës në thellësi. Ndoshta treni ynë është nisur për këtë zbulim.»

Doja të ngrihesha në këmbë.

— Mos do gjë unaza? — më pyeti kurbatka. — Ja ku i kam. — Nxori një kuti kartoni me unaza dhe filloi t'i fuste me radhë nëpër gishtërinj. Pastaj më zgjati dorën nën hundë.

Burri u ngrit dhe i shkau libri.

— Turp të kesh! S'ke faj ti, e ka fajin këshilli i lagjes, që të lë akoma të bredhësh e t'u shesësh njerëzve ato shëmtirat e tua. Infekton edhe të tjerët!

Kurbatka nuk lëvizi, pastaj u çua ngadalë, futi gjirin brenda dhe më lëshoi fëmijën në prehër. Shkundi fustanin, vuri duart në ije dhe ia nguli sytë burrit.

— Mua do ma tregosh ti qeverinë, mor shok? Se qenkam jevgë e s'e ditkam unë. S'e njeh vëllanë tim që e ka shtëpinë në mes të Lushnjës e i bën përshesh tokat me traktor. I dalluar është. Dhe babanë e kam rojë në depot e drithit. Po e di unë se ç'do ti. Do ca saçma në ato menderet që të të vijë mendja në vend.

Burri mezi përmbahej dhe filloi të hante thonjtë.

— Po mjaft, moj shokë, se s'ka lezet, — tha një nga punëtorët e ndenjësës tjetër.

— Rri aty ti, shok, se s'di gjë ti! Më shau.

Burri me libër zbriti në stacionin e parë. Kurbatka më shkeli syrin.

— E pe? Kot zbriti. Kushedi ku do shkonte.

Ajo filloi të guduliste fëmijën e të qeshte.

— Ku do të shkosh? — e pyeta.

— Në Kavajë. Do filloj punë në fabrikën e

qilimave. Kjo është e treta herë, e treta e vërteta. S'leviz më.

— Pse e gënjeve atë burrin?

— Kot. S'më pëlqeu, se më pa me inat që kur erdha. Por unë edhe këto pesë copë unaza do t'i shes, janë të fundit.

Punëtorët qeshën. Edhe plaka.

— Ih, qenke e prapë, — tha njëri nga punëtorët.

— Rri, mori drakule, — tha kurbatka dhe u zgërdhi.

— Kot u zure me atë burrin.

— S'ka gjë, kur ta takosh, thuaji se kam hyrë në punë. Tani ditën e mirë. — U tundi dorën punëtorëve dhe zbriti në Kavajë, me trastën në kurriz dhe fëmijën hedhur në krah si plaçkë.

E shihja tek ecte duke valëvitur kindat e fustanit e duke gudulisur fëmijën. Ngriti dorën pa e kthyer kokën dhe u zhduk pas kthesës.

— Të ka faj, — tha plaka dhe qeshi me gojën pa dhëmbë.

Hipën një djalë dhe një vajzë. Kishin të dy një gjatësi, sikur qenë prerë me gërshtë.

— Mund të ulemi? — tha vajza dhe tërhoqi djalin për mënge.

Në tren kishte zhurmë. Një fëmijë këndonte, ndërsa djemtë e ndenjësës mbrapa qeshnin fort, pa pyetur për të tjerët.

Djali dhe vajza filluan të flitnin me zë të ulët dhe pandehnin se s'i dëgjonte njeri. Dukej se kishin lënë një bisedë përgjysmë.

— Dua të të them dy gjëra, — tha djali. I kishte